

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Sekuestrohen 2 milionë euro kokainë në kontejnerin me mish pule nga Brazili
ADRESA	https://www.reporter.al/2026/09/14/sekuestrohen-2-milione-euro-kokaine-ne-kontejnerin-me-mish-pule-nga-brazili/
BURIMI	reporter.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 12:17:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 1800 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 12:08:36 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	565680f95b3ede398769733ab9c727d6a665419e6319a20351f6367f4362bdef
TEKSTI	8ad5eb4c4b03bd165841fc92d67a0f62224d53a40f72b61a8f28bf200ccc3ce5
PAMJA	c185bfe99c38e3a8f4b7adc186038c1d549c51c6532365c2f2cded8d5a85d87b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8fb30e569e32823775a9191205fbbd0554124382dd60144266dea377274c674a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	47dca60bb12c3dc439ebb43dab156a56f0c4323b738cbf9a7b5f92b8b605451e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8fb30e569e32823775a9191205fbbd0554124382dd60144266dea377274c674a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kryefaqja Lajme

Sekuestrohen 2 milionë euro kokainë në kontejnerin me mish pule nga Brazili

Policia e Durrësit njoftoi se kishte gjetur dhe sekuestruar një sasi prej 41 kilogramësh kokainë të fshehur në pjesën e jashtme të një kontejneri me mish pule që vinte nga Brazili.

nga Vladimir Karaj — 15 seconds më parë në Lajme Koha e leximit: 1 min lexim

AA 0



Droga e kapur në Durrës. Foto: Screenshot nga video e postuar nga Policia e Shtetit.

Autoritetet policore dhe doganore sekuestruan të hënën 41.35 kilogramë kokainë në një kontejner që vinte nga Brazili, duke shënuar rastin e tretë të goditjes së trafikut të drogës në portin më të madh të vendit brenda një muaji.

Sipas njoftimit zyrtar të Policisë së Shtetit, lënda narkotike u zbulua gjatë operacionit të koduar "Anchor 3". Kontejneri, i cili sipas dokumentacionit shoqërues transportonte mish pule, u mbajt nën vëzhgim dhe iu nënshtua një kontrolli të intërsishëm nga Sektori për Hetimin e Narkotikëve, në bashkëpunim me Policinë Kufitare dhe strukturat doganore.

"Gjatë kontrollit të kontejnerit, në kapakët e jashtëm të tij u konstatuan 37 paketime me lëndë të dyshuar narkotike kokainë", thuhet në njoftim. Në videon që shoqëron njoftimin për media, droga duket e paketuar në pako me mbështjellje plastike me ngjyra të ndezura.

Autoritetet përlogarasin se sasia e sekuestruar kap një vlerë tregu prej rreth 2 milionë eurosh.

Në njoftimin e policisë nuk raportohet për persona të arrestuar deri në këtë fazë të operacionit dhe as nuk bëhet i ditur emri i kompanisë që po importonte mishin e pulës.

Etiketa: Brazil kokaine kontrabandë operacioni Anchor 3 Policia e Shtetit
Porti i Durrësit sekuestrim droge Trafik Droge

Sekuestrohen 2 milionë euro kokainë në kontejnerin me mish pule nga Brazili

14:08 | 14/09/2026

Në bastionet e ish-guerilëve kosovarë, vendimi i afërt gjyqësor nxit zemërim dhe mbështetje të fortë

12:36 | 14/09/2026

Maqedonia e Veriut rishikon rregullat për "pasaportat e arta", por shqetësimet e BE-së mbeten

11:24 | 14/09/2026

Të rinjtë shfrytëzohen si vrasës me pagesë në "luftërat" e drogës në Ballkan

11:10 | 14/09/2026

I dërguari i Trump, me mision lobimi në Tiranë për rizgjedhjen e kreut të FIFA

06:54 | 14/09/2026

"Bed & Breakfast": Në Durrës, bizneset po heqin dorë nga numërimi i turistëve

07:47 | 13/09/2026

Lajme
Blog
Rajoni

Politika e privatësisë dhe
rregulla të tjera
Letra për redaktorin

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara
© 2014 - 2026 Reporter.al - BIRN
Dev by Sfida.PRO

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.